



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3468/prot.
7

Pogradec, më 13, 08, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Zj. Manjola Kamolli
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuara zonja Kryetare,
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues për dhënien e titullit të nderit “Krenaria e Qytetit” për **Festim Fetollari (Pas Vdekjes)** dhe **Spartak Elmazi (Pas Vdekjes)**

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 3 (tre)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

PROJEKT VENDIM

Nr. ____, datë ____ . ____ .2024

**PËR MIRATIMIN E TITULLIT
“ KRENARIA E QYTETIT”**

për

FESTIM FETOLLARI (PAS VDEKJES)

SPARTAK ELMAZI (PAS VDEKJES)


Këshilli Bashkiak Pogradec në mbledhjen e datës ____ . ____ .2024, me propozim të një grup qytetarësh , ish sportistësh dhe me miratim nga Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve të nderit, mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 54 germa “m” e tij, ligjit nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “ Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve Këshillimore për dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë dhe Rregullores së Bashkisë Pogradec “Për llojet e Titujve te Nderit, Kriteret dhe Proceduren e dhënies së tyre” Neni 5.

VENDOSI

1. Miratimin e dhënies së titullit të nderit “ **KRENARIA E QYTETIT**” të ish futbollistëve

FESTIM FETOLLARI (PAS VDEKJES)

Me motivacion: **Për kontributin e shquar dhe rezultate të larta që ka dhënë ndër vite si sportist , trajner në qytetin e Pogradecit duke qenë shëmbull për brezat e rinj.**



SPARTAK ELMAZI (PAS VDEKJES)

Me motivacion: **Për kontributin , rezultatet e larta që ka dhënë ndër vite si sportist , ka mbështetur talentet e reja në futboll duke spikatur me sjelljen e tij shëmbullore e qytetare.**

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Pogradec.

K R Y E T A R
MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin për miratimin e titullit të nderit **“Krenaria e Qytetit” për Festim Fetollari (Pas Vdekjes) dhe Spartak Elmazi (Pas Vdekjes)**

I nderuar Kryetar i Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë!

Propozimi i mësipërme për dhënien e titullit të nderit **“Krenaria e Qytetit” për Festim Fetollari (Pas Vdekjes) dhe Spartak Elmazi (Pas Vdekjes)** bëhet në respekt të figurës dhe kontributeve të tij në qytetin e Pogradecit.

Projekt vendimi që po ju paraqesim është rrjedhojë e detyrimit ligjor që ka Institucioni i Bashkisë Pogradec, për të bërë të mundur dhënien për miratimin e titullit të nderit **“KRENARIA E QYTETIT”**, por dhe detyrimi shpirtëror ndaj figurës së tij e cilat janë përshkruar hollësisht në jetëshkrimet e Festim Fetulla dhe Spartak Elmazi.

Kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak të akordojë titullin **“Krenaria e Qytetit” për Festim Fetollari (Pas Vdekjes) dhe Spartak Elmazi (Pas Vdekjes)**

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Faleminderit!

Konceptoi: Juriste

Erinda Kamolli

Pranoi: Kryetare e Komisionit Këshillimor
Për dhënie të titujve të nderit

Entela Gusho

Miratoi: **SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Dritan Babasuli



CV e ish-futbollistit Festim Fetollari

Festim Fetollari lindi në Korçë më 16.08.1969

Ish futbollisti i njohur i Pogradecit dhe Skenderbeut Festim Fetollari lojën e futbollit do ta niste në Korçë me ekipin e para te rinjve të Skenderbeut. Por duke qenë se jetonte larg nga Korça e kishte te veshtirë për ta vijuar normalisht stërvitjen. Ndaj dhe vendos ta vazhdojë magjinë e futbollit në Pogradec, pasi fshati i tij Pirg, ishte me pranë këtij qyteti.

Trajnerët e tij, Urim Jorgoni dhe Kopi Gusho e kanë përfshirë menjëherë si titullar me ekipin e të rinjve, por shumë shpejt mesfushori i talentuar do të kalonte në të rriturit e skuadrës liqenore ku luan deri në vitin 1994 me një grup futbollistësh, padyshim me të mirët e gjithë historisë së futbollit pogradecar, nga Janaqi e Blacëri, Bashllari e Abazaj, Çekiçi e Laçka e shumë të tjerë, të cilët bënë gjithçka për ekipin e tyre.

Pas këtij viti, Fetollarin e shikojmë si futbollist të Skënderbeut aty ku luan deri në vitin 1999, për t'u rikthyer edhe njëherë tjetër tek Pogradeci, aty ku dhe mbyll gjithçka si futbollist.

Më vonë Fetollarin e shikojmë si trajner pranë Klubit "Pogradeci" kur liqenorët luanin në kategorinë e parë. Për një sezon ishte edhe trajner i skuadrës së Devollit për t'u rikthyer edhe njëherë tjetër pranë akademisë së futbollit pogradecar, ku mori persipër të drejtojë një grup futbollistësh të vegjël U11, të cilëve iu mësonte magjinë e kësaj loje.

Ndroi jetë në 07.06.2023, në moshën 54 vjeçare

Me largimin nga jeta të Festim Fetollarit, Pogradeci dhe Skenderbeu kanë humbur një nga futbollistët më të njohur në 30 vitet e fundit. Fetollari ishte nga ajo "rracë" mesfushorësh shkatërrues, që sot i mungon futbollit shqiptar.



CV e ish-futbollistit Spartak Elmazi

Spartak Elmazi lindi më 3 dhjetor 1987 në qytetin e Korçës.

Në vitin 1996 familja e tij u largua nga fshati Sheqeras dhe u vendos në Pogradec .Historia e tij me futbollin lindi në këtë qytet ku hodhi hapat e parë si futbollist dhe fillimisht luajti me ekipet e moshave.

Në moshën 18-vjeçare kur ishte ende gjimnazist debutoi me skuadrën e parë të qytetit dhe në atë kohë u konsiderua nga trajnerët dhe opinioni sportiv si një talent i rrallë.

Kur mbaroi shkollën e mesme duhet të zgjidhte mes futbollit dhe studimeve në Universitet, ai i vazhdoi të dyja. Paradite studionte në Universitetin “Fan Noli” duke sakrifikuar çdo ditë udhëtonte për në Korçë e fill mbas studimeve në Stadium për stërvitje.

Edhe pse më angazhime të mëdha gjente kohë të ndihmonte prindërit në biznesin e tyre modest familjar.

Spartak Elmazi luajti për pesë sezone me Ekipin e “Pogradecit” ku në sezonin 2010-2011 u shpall kampion i kategorisë së parë dhe lojtari më i mirë i sezonit .

Në sezonin e ardhshëm 2011-2012 luajti me më të mirët e futbollit shqiptar në superligë po për skuadrën e “Pogradecit”.

Pas pesë sezonesh vendosë të lerë skuadrën e zemrës dhe u transferua tek “Tomorri” i Beratit ku në atë sezon luajti po në superligë. Pas një sondazhi të organizuar nga tifozët beratas në fund të sezonit ai u shpall si lojtari më i mirë. Në vitet në vazhdim luajti për “Kastriotin” po në superligë, me Mamurasin, Dinamon dhe Kamzën në kategorinë e parë ku fitoi edhe një kupë tjetër me Kamzën si kampion në kategorinë e parë në sezonin 2016-2017.

Në sezonin 2017-2018 u rikthye të luajë për “Dinamon” e Tiranës, një nga skuadrat me shumë histori në futbollin shqiptar. Por në kohën që Elmazi luajti aty, ato ishin vitet më të vështira financiare për atë klub dhe për këtë sakrificë flitet edhe sot nga tifozët dhe ish-shokët e skuadrës.

Vendosi që të lerë futbollin në sezonin 2018-2019 dhe vazhdoi kursin për trajner pranë FSHF.

Pas mbarimit të kursit fillloi punë në Akademinë e Futbollit “Dinamo” së bashku me ish-futbollistët e mirënjohur si Arian Pisha, Artion Poçi e Roland Peqini.

Në perudhën që ka qënë trajnier një rol të veçantë ka patur në mbështetjen e talenteve të rinj.

Në kulmin e karrierës së tij diagnostifikohet me një sëmundje të rëndë por sërish vazhdoi të punojë me pasion edhe pse vazhdonte kurimin.

Luftoi fort për rreth tre vite me sëmundjen duke habitur edhe doktorët, por në fund nuk ia doli.

Ndron jetë në 19 dhjetor 2021 në moshën 34 vjeçare .

Spartaku do të kujtohet gjithmonë përveçse futbollit i mirënjohur jo vetën në qytetin tonë por edhe në Skuadra të tjera të Shqipërisë por dhe si një djalë shembull me kulturë të gjërë , i respektuar nga të gjithë sportdashësit dhe bashkëqytetarët.